

varrosur në varrezat e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. Në muajin gusht të vitit 2002, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e Syriganës/Suvo Grlo. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Rexhepit është sistemuar në lëndën me numër BLG-803858-01, ndërkaq ai i Osmanit me BLG-803859-01.

Burimet: deklarata S.U, FDH-20299; deklarata S.U, FDH-36707; deklarata S.S, FDH-16655; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, X, 369; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Ujkan (Hamit) Rushiti

(25.11.1940, shqiptar nga Syriganë/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, shtatë fëmijë)

Mahmut (Rrustem) Rushiti

(1.05.1945, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, katër fëmijë, civil)

Isuf (Januz) Rushiti

(19.04.1952, shqiptar nga Syriganë/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, rojtar në Fabrikën e Municionit, shtatë fëmijë)

Në mesin e burrave që në mëngjes, më **8.06.1998**, për shkak të sulmit të forcave serbe [Syriganë/Suvo Grlo] u strehuan në shtëpinë e familjes Uka, ishin edhe kushërinjtë Isufi dhe Ujkani. Atje ndodhej edhe i afërmi i tyre, Mahmuti, i cili ka ardhur në fshat në fillim të muajit qershor të vitit 1998, për ta bindur të vëllain që me familje të kalonin tek ai në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica, por nuk ka mundur të kthehej më për shkak të bllokimit të rrugëve.

Mahmutin, Ujkanin dhe Isufin i shihnin për herë të fundit të gjallë nga ora 14:00, kur e kanë braktisur shtëpinë e Abit Ukes [Syriganë/Suvo Grlo], në çastet kur forcat serbe po i afroreshin kësaj shtëpie. Në mëngjesin e ditës tjetër, trupat e tyre të pajetë i ka gjetur banori i fshatit, Sokol Uka. Gjendeshin në një gropë, në vendin e quajtur *Kodra e Gurit/Kameni breg*, afro 150 metra larg rrugës së asfaltuar. Ai e ftoi menjëherë vëllain e Isufit, Sejdiun, dhe kushëririn Shefqetin që t'i bartnin trupat e të vrarëve në fshat, por e ndërruan mendjen për shkak të pranisë së madhe të

forcave serbe. I kanë lënë trupat atje ku ishin. U kthyen pas dy javësh, por trupat nuk gjendeshin më atje. Vetëm pas lufte, më 10.08.1999, mbetjet mortore të Mahmutit, Ujkanit dhe Isufit u gjetën në një fushë. Ishin të varrosur në një varr që nuk ishte i thellë. Familjet i kanë varrosur mbetjet e tyre mortore një ditë më vonë në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.R, FDH-16654; deklarata A.R, FDH-15427; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 206, FDH-23816; *Serb Forces Kill Three Albanians at Skenderaj Village Tuesday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.08.1998, FDH-29312.

Milosav (Jevrem) Šmigić

(1922, serb nga Leçina/Leočina, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, gjashtë fëmijë)

Sultana (Miladin Simić) Šmigić

(1924, serbe nga Leçina/Leočina, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, gjashtë fëmijë)

Aleksandra (Pavle Veselinović)

Šmigić - Lena

(15.06.1928, serbe nga Leçina/Leočina, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, vejuhë, dy fëmijë)

Radomir (Vladimir) Šmigić -

Doma

(12.08.1945, serb nga Leçina/Leočina, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, i pamartuar)

Para lufte, në Leçinë/Leočina jetonin afro 40 anëtarë të familjes Šmigić. Pas rrëmbimit të Dostanes Šmigić [të shikohet regjistrimi], në muajin maj të vitit 1998, në fshat ndenjen vetëm qifti i moshëthyer bashkëshortor, Milosav dhe Sultana, djali i vëllait të Milosavit, Radomiri, me nënën Aleksandren, si dhe nëna e Dostanës, Krstiva.

Ditën e martë, më **9.06.1998**, rreth orës 11:00, afro 30 shqiptarë të armatosur dhe të veshur në uniforma kanë hyrë në lagjen e familjes Šmigić [Leçinë/Leočina] dhe filluan tu vënin zjarrin shtëpive. Në shtëpinë e Milosavit gjendeshin ai, Sultana dhe Krstiva. Katër ushtarë kanë hyrë në shtëpinë e Milosavit. Kërkuan armë dhe kur ai u tha se nuk i kishte, e goditën me kondak. I qëlluan edhe Sultanen dhe Krstiven dhe, më pas, u urdhëruan që të hynin